

<p><b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHITJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</b></p>	<p><b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</b></p>	<p><b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKE POVERENIČKU AGENCIJU</b></p>
---	---	--

Në padinë e

**ASC-10-0028**

1. [REDACTED]
2. [REDACTED]
3. [REDACTED], Prishtinë

*Paditësit/Ankuesit*

kundër

1. [REDACTED]  
Fushë Kosovë
2. [REDACTED]  
Llapje Sellë

*Të Paditurit*

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetari i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 gusht 2010, lëshon këtë

### **A K T V E N D I M**

1. Ankesa është e bazuar. Aktvendimi i Trupit Gjykues në lëndën SCC-09-0078 i datës 14 janar 2010 refuzohet. Trupi Gjykues – në një përbërje tjetër – urdhërohet ta rigjykojë lëndën.
2. Me rastin e ankesës, aktvendimi i gjyqtarit individual të Trupit Gjykues në lëndën SCC-09-0078 i datës 29 prill 2010 refuzohet.
3. Shpenzimet për procedurën ankimore nuk do të ngarkohen.

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 14 maj 2009, Paditësit parashtuan një padi pranë DHPGJS-së, duke kërkuar anulimin e kontratës së shitblerjes që ka të bëjë me pronën e paluajtshme e cila i takonte babait të tyre të ndjerë, [REDAKTUAR], dhe duke kërkuar rikthimin e asaj prone tek ata. Trupi Gjykses më 28 maj 2009 lëshoi një urdhër për sqarim, duke u kërkuar Paditësve që të ofrojnë dëshmi se ata janë trashëgimtarët ligjor të [REDAKTUAR] dhe "të gjitha dëshmitë që Paditësit kanë ndërmend t'i sjellin në Gjykatë" brenda 14 ditëve. Paditësit i janë përmbajtur atij urdhri.

Duke iu përgjigjur një urdhri tjetër për sqarim nga gjykata, duke u kërkuar atyre ndër të tjera të paraqesin "në pajtim me Nenin 28.2 (e) të UA të UNMIK-ut 2008/6 dëshmi se Paditësit e kanë njoftuar Agjencinë se ka ndërmend të paraqesë padi kundër Ndërmarrjes dhe AKM-së brenda periudhës së paraparë në bazë të neneve 29.1 ose 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12, e ndryshuar", Paditësit dorëzuan një njoftim tek Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) më datën 10 qershor 2009.

Me aktvendimin e datës 14 janar 2010, Trupi Gjykses, i përbërë nga dy gjyqtar ndërkombëtar dhe një gjyqtar vendor, e hodhën poshtë padinë si të papranueshme, duke pohuar se "Paditësit nuk kanë paraqitur asnjë fakt ose dëshmi që do të tregonin pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes. Paditësit nuk kanë sqaruar argumentet ligjore për padinë e tyre siç përcaktohet sipas Nenit 27.2 (e) të UA të UNMIK-ut 2008/6. Nga parashtrësja e Paditësve e datës 4 gusht 2009 shihet se Paditësit nuk kanë arritur ta njoftojnë Agjencinë se kanë ndërmend të paraqesin padi siç kërkohet në bazë të nenit 28.2 (e) të UA të UNMIK-ut 2008/6. Në fakt, Njoftimi i parashtuar ka datën 10 qershor 2009, që është pasi që Paditësit kanë parashtuar padinë e tyre në DHPGJS."

Paditësit më 1 mars 2010 parashtuan një ankesë kundër këtij aktvendimi, e cila ishte dërguar tek ata më 02 shkurt 2010, duke i kërkuar Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së ta refuzojnë aktvendimin e lartpërmendur dhe ta kthejnë lëndën në shkallën e parë për rigjykim, ose ta ndryshojnë atë dhe ta miratojnë padinë e Paditësve.

### III

Më 11 shkurt 2010 Paditësit tashmë e kishin dorëzuar tek Trupi Gjykses një kërkesë për kthimin në gjendjen e mëparshme. Gjyqtari individual i Trupit Gjykses me aktvendimin e datës 29 prill 2010 pranoi kërkesën e Paditësve "për kthimin në gjendjen e mëparshme" dhe e shpalli aktvendimin e tij të datës 14 janar 2010 si *null dhe të pavlefshëm*.

Në rrethanat faktike dhe procedurale të këtij aktvendimi të datës 29 prill 2010 thuhet:

*"(...) Dhoma e Posaçme e refuzoi padinë si të papranueshme për shkak të arsyes kryesore se Paditësit nuk e kanë dorëzuar një njoftim të dërguar tek Agjencia para ushtrimit të padisë. Dhoma e Posaçme gjithashtu theksoi se Paditësit nuk kanë paraqitur asnjë fakt ose dëshmi që do të tregonte pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes dhe se nuk kanë sqaruar argumentet ligjore për padinë. (...)"*

Në arsyetimin ligjor thuhet si në vijim:

*"(...) Me padinë e tyre, Paditësit parashtruan një njoftim të pranuar nga AKM-ja më 17 shkurt 2005, të dërguar nga paraardhësi i tyre, [REDAKTUAR] i cili e kishte njoftuar Agjencinë për procedurën gjyqësore e cila zhvillohej në Gjykatën Komonale të Prishtinës sipas C.nr.500/2004 lidhur me padinë e tij për anulimin e kontratës së shitblerjes Vr.nr.164.*

*Kjo procedurë gjyqësore ishte ndërprerë me një aktvendim të lëshuar më 28 janar 2009 nga Gjykata Komonale për shkak të vdekjes së [REDAKTUAR].*

*Paditësit rifilluan procedurën gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme nëpërmjet padisë së tyre të ushtruar më 14 maj 2009, objekti i së cilës padë është i njëjtë si i paraardhësit të tyre.*

*Njoftimi i Agjencisë ka të bëjë me padinë e njëjtë së pari të ushtruar pranë Gjykatës Komonale të Prishtinës nga [REDAKTUAR], e më pas pranë Dhomës së Posaçme nga trashëgimtarët e tij.*

#### IV

*(...) Megjithatë, një njoftim i tillë i cili i ishte dhënë Agjencisë pas afatit në procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Komunale mund të konsiderohet si i parashtruar në mënyrë të rregullt tek Agjencia e njëjtë për procedurën gjyqësore të mëtutjeshme pranë Dhomës së Posaçme të rifilluar nga trashëgimtarët më 14 maj 2009. (...)*

Trupi Gjykues nuk ka përmendur, as në rrethanat faktike dhe procedurale dhe as në arsyetimin ligjor, asnjë fakt të ri ose parashtrësë lidhur me dëshmitë të cilat i ka deklaruar që mungojnë në aktvendimin e tij të parë. Gjithashtu nuk ka as të tilla parashtrësë të reja në shkresën e lëndës. Arsyetimi ligjor i tij vazhdon si në vijim:

*"(...) Përveç kësaj, Dhoma e Posaçme vlerëson se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që shpjegojnë mosdorëzimin e njoftimit të dhënë për Agjencinë nga ana e Paditësve brenda afatit të urdhrit të lëshuar më 16 korrik 2009. Me rifillimin e procedurës gjyqësore të paraardhësve të tyre, ata nuk kanë mundur të jenë të vetëdijshëm për faktin se një njoftim ishte dorëzuar nga ai në vitin 2005 dhe se ky dokument mund të ishte paraqitur në Dhomën e Posaçme.*

*(...) Në pajtim me Nenin 122 të Ligjit të mësipërm mbi Procedurës Kontestimore, ky aktvendim nuk është i ankueshëm."*

Trupi Gjykues nuk ka përmendur asnjë aktvendim të Gjykatës Komunale të Prishtinës ose të vetë Trupit Gjykues që e ka transferuar lëndën nga ajo gjykatë tek DHPGJS-ja. Gjithashtu nuk ka asnjë vendim të tillë në shkresën e lëndës.

Pasi që aktvendimi kundër të cilit është ushtruar ankesa ishte shpallur null dhe i pavlefshëm nga Trupi Gjykues, Kolegji i Ankesave më 19 korrik 2010 u kërkoi Paditësve/Ankuesve të sqarojnë nëse ata e tërheqin ankesën e tyre të ushtruar kundër aktvendimit të Trupit Gjykues të datës 14 janar 2010.

Paditësit/Ankuesit u përgjigjën ndaj këtij urdhri dhe e njoftuan DHPGJS-në se ata e tërheqin ankesën e ushtruar kundër aktvendimit të datës 14 janar 2010, pasi që ky aktvendim ishte shpallur null dhe i pavlefshëm me aktvendimin e datës 29 prill 2010.

**Arsyetimi ligjor:**Tërheqja e ankesës

Rregullorja e UNMIK-ut 2008/4 dhe Urdhëresa Administrative (UA) e UNMIK-ut 2008/6 nuk përmbajnë dispozita që kanë të bëjnë me tërheqjen e ankesës. Neni 26.1 i UA të UNMIK-ut 2008/6 që ka të bëjë me paditë përcakton se Paditësi mund që në çdo kohë ta tërheqë padinë, me pëlqimin e DHPGJS-së. Me dhënien e pëlqimit të saj, DHPGJS-ja duhet të ketë parasysh interesat e të gjitha palëve të tjera. Neni 58.2 i UA të UNMIK-ut përcakton se rregullat procedurale me të cilat drejtohet procedura gjyqësore në Trupin Gjyqësor duhet të zbatohen mutatis mutandis në procedurën gjyqësore në Kolegjin e Ankesave. Me leximin e Neneve të lartpërmendura 26.1 dhe 58.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6 bashkërisht, Kolegji i Ankesave vlerëson se në raste të jashtëzakonshme gjithashtu edhe tërheqja e ankesës do të mund të varet nga pëlqimi i DHPGJS-së (shih ASC-09-0034).

Rasti në fjalë është i jashtëzakonshëm në atë kuptim dhe andaj ankesa nuk mund të konsiderohet që të tërhiqet me shpalljen e tërheqjes. Lënda është e jashtëzakonshme në kuptimin e definicionit të mësipërm, në qoftë se interesat e të gjitha palëve të tjera të lëndës, dhe, pas ratio legis së dispozitës, vetë interesi i drejtësisë është në pikëpyetje nëse pranohet tërheqja. Ky mund të jetë rasti, nëse aktvendimi i cili është i ankimuar, duke u bërë ligjërisht i detyrueshëm, do të shkelte ligjin ose do të rrezikonte të drejtat e atyre të cilat janë palë në padi por nuk janë ankuar kundër aktvendimit të kundërshtuar.

Në rastin në fjalë, aktvendimi i ankimuar si dhe aktvendimi i ndërmarrë nga gjyqtari individual i Trupit Gjyqësor duke shpallur aktvendimin e përmendur më parë null dhe të pavlefshëm shkelin rregullat procedurale bazë. Prandaj dhënia e pëlqimit për tërheqjen e ankesës do të rrezikonte interesin e vetë drejtësisë dhe gjithashtu do të rrezikonte të drejtat e palëve të tjera në këtë padi, të cilët nuk ishin përfshirë ende në mënyrën e duhur (shih më poshtë).

## Zbatimi i gabuar i rregullave procedurale

1. Aktvendimi për hedhjen poshtë të padisë si e papranueshme është i gabuar dhe duhet të refuzohet.

a. Mungesa e provave dhe paraqitja e argumenteve ligjore

Neni 28.2 (f) i UA të UNMIK-ut 2008/6 në mes të kriterëve të pranueshmërisë për padinë rendit (të gjitha) "... kërkesat e Neneve 25 dhe 27 ...", në shikim të parë japin përshtypjen se të gjitha elementet e renditura aty do të mund të çonin në hedhjen poshtë të padisë si e papranueshme, nëse nuk parashihet me urdhër (shih Nenin 28.4 të UA të UNMIK-ut 2008/6). Një pasqyrim më i afërm, megjithatë tregon se fushëveprimi i kësaj dispozite duhet të zvogëlohet për shkak të arsyeve teleologjike (shih ASC-09-0072 etj.):

Me sa duket, një nga parimet kryesore të përbashkëta të Kodeve Civile Procedurale të kontinentit të Evropës është përfundimi i padisë (sikur pyetja nëse faktet e pohuara, në lidhje me argumentet ligjore të paraqitura do të mund të kenë pasojë ligjore siç kërkohet në padi) duke mos qenë një çështje e pranueshmërisë së padisë, por e meritave të saj. Në qoftë se nuk paraqiten faktet (e mjaftueshme) dhe ose argumentet ligjore, ose faktet e pohuara nuk çojnë në përfundimin e bërë nga Paditësi, padia vetëm mund t'i nënshtrohet refuzimit si e papranueshme, nëse nuk sqarohet me kërkesë.

E njëjta gjë vlen edhe për emërimin e dëshmimeve të cilat kanë ndërmend që t'i paraqesin Paditësit: Në parim, vetëm faktet e kundërshtuara duhet të vërtetohen nga Paditësi. Nëse i Padituri nuk i kundërshton faktet e pohuara në padinë përfundimtare, nuk është e nevojshme që të merren dëshmitë. Një "listë e dëshmimeve" mund të jetë e dobishme vetëm nëse mbledhja e dëshmimeve është e nevojshme. Nëse fare, një padi do të mund të refuzohet si e pabazë nëse Paditësi nuk arrin të paraqesë dëshmi që vërtetojnë faktet të cila i ka kundërshtuar i Padituri. Para përfshirjes së të Paditurit, një listë e dëshmimeve do të mund të kërkohet, nëse Paditësi ka për të sqaruar lidhur me çështjet e tjera, sidoqoftë, por nuk mund të jetë një çështje në atë fazë të procedurës gjyqësore. Për më tepër, lista e cila mungon nuk mund të çon kurrë në hedhjen poshtë të padisë.

## VII

Në rastin në fjalë, të Paditurit ende nuk janë përfshirë. Prandaj provat materiale, lista e dëshmive dhe argumentet ligjore nuk janë ende çështje relevante. Veç kësaj, nuk mund të shihet se deri në çfarë mase Trupi Gjykues e vlerëson padinë të jetë e pamjaftueshme: Faktet dhe argumentet ligjore jepen (pronësia e pretenduar për ngastrën e tokës përkatëse, pavlefshmëria e kontratës së shitblerjes, gjendja e Paditësve si trashëgimtar të ish pronarit), së bashku me dëshmitë për t'i përdorur (emrat e dëshmitarëve, së paku emrat në dokumentet e bashkëngjitura në padi; dokumentet si kontrata e kundërshtuar). Trupi Gjykues nuk ka kërkuar sqarime lidhur me ndonjë çështje të caktuar por vetëm u ka kërkuar Paditësve të parashtrojnë *"të gjitha dëshmitë të cilat Paditësit kanë ndërmend t'i sjellin në gjykatë"*. Kjo nuk është specifikisht e mjaftueshme që, nëse nuk ndiqet nga Paditësit, të jetë një arsye e vlefshme për ta hedhur poshtë padinë si e papranueshme; siç tregohet më lartë, mosparashtrimi i dëshmive do të mund të çojë në refuzimin e padisë vetëm në një fazë të mëvonshme, pas kërkesës së specifikuar dhe të detajuar për parashtrimin e dëshmive për një fakt specifik të pohuar.

Si rrjedhojë, arsyetimi ligjor i trupit Gjykues sa i përket çështjes së fakteve, dëshmive dhe argumenteve nuk mund të ndiqet.

### b. Njoftimi i Agjencisë (Neni 28.2 [e] i UA të UNMIK-ut 2008/6):

Sipas Nenit 29.1 të RREG së UNMIK-ut 2002/12 (i lidhur me Nenin 28.2 [e] të UA të UNMIK-ut 2008/6), njoftimi me shkrim i qëllimit për të parashtruar veprim kundër një NSH-je duhet t'i jepet Agjencisë para parashtrimit të padisë (gjithashtu edhe referimi i Trupit Gjykues tek Neni 30.2 i RREG së UNMIK-ut 2002/12 është i gabuar, pasi që kjo dispozitë zbatohet vetëm për paditë kundër Agjencisë). Njoftimi i Agjencisë lidhur me qëllimin e ushtrimit të padisë është gjithashtu njëra nga kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Nenin 28.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6. Edhe pse kriteret e pranueshmërisë duhet të shqyrtohen ex officio, në atë fazë të hershme të procedurës gjyqësore (ende pa u përfshirë i Padituri) thjeshtë pretendimi nga Paditësi se ishte paraqitur njoftimi i duhur, është – në parim – i mjaftueshëm, sipas modelit të njëjtë siç përshkruhet më lartë. Nëse Paditësi pohon (në padi ose pas urdhrit në pajtim me Nenin 28.4 të UA të UNMIK-ut 2008/6) se ishte paraqitur njoftimi i duhur, Trupi

## VIII

Gjykues nuk mund ta hedh poshtë padinë si të papranueshme për shkak të kësaj arsyeje. Përveç nëse padia është e papranueshme mbi baza të tjera, duhet t'i jep të Paditurit mundësinë për ta marrë një qëndrim për njoftimin (e pohuar), së bashku me meritat e lëndës (duke dërguar padinë dhe dokumentet e tjera tek i Padituri; *audiatur et altera pars*). Pastaj i takon të Paditurit t'i kundërshtojë faktet siç pohohet në padi, duke përfshirë njoftimin e pohuar (të afateve kohore). Vetëm nëse i Padituri e kundërshton (afatin kohor të) njoftimit, Paditësit do t'i kërkohet ta vërtetojë njoftimin.

Në rastin në fjalë, të Paditurit nuk kanë pasur mundësinë ta kundërshtojnë ende njoftimin. Paditësit dorëzuan një kopje të njoftimit të datës 10 qershor 2009, por, duke treguar qartë se ishte ushtruar pas parashtrimit të padisë (14 maj 2009), dhe andaj duke mos qenë në përputhshmëri me Nenin 29.1 të RREG së UNMIK-ut 2002/12 i lidhur me Nenin 28.2 (e) të UA të UNMIK-ut 2008/6. Në këto rrethana nuk është shfaqur ndonjë nevojë e mëtutjeshme për ta përfshirë të Paditurin; pas parashtrësës së Paditësve të datës 4 gusht 2009, ishte tashmë e qartë (pa ndonjë paragjykim për kualifikimin ligjor të njoftimit të dhënë nga paraardhësi i Paditësve tek AKM-ja) se jo të gjitha kriteret e pranueshmërisë ishin plotësuar në datën e ushtrimit të padisë.

Megjithatë, ende pa e marrë parasysh njoftimin e dhënë nga paraardhësi i Paditësve tek AKM-ja, këtu duhet të konsiderohet se që nga 10 qershori 2009 Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ishte në dijeni për padinë. Që nga atëherë, ata nuk kanë zgjedhë të futen në procedurën gjyqësore si përfaqësuesit e të Paditurve. Duke pasur parasysh se qëllimi i njoftimit është që të njoftojë Agjencinë për paditë (e mundshme), dhe t'u ofrojë atyre mundësinë që të marrin çështjen në emër të NSH-së, synimi i njoftimit ishte arritur (në ndërkohë). Përveç kësaj, duhet të merret parasysh se detyra e një paditësi për ta njoftuar Agjencinë paraprakisht i shton atij një barrë shtesë për qasje në drejtësi, dhe andaj duhet të interpretohet në mënyrë të kufizuar. Nën rrethanat e veçanta të lëndës do të mund të konsiderohej madje edhe si shpërdorim i së drejtës ligjore, nëse (AKP-ja në emër të) të Paditurve tani do t'i referoheshin njoftimit të paafatshëm. Në këtë situatë specifike, Kolegji i Ankesave e konsideron njoftimin e paafatshëm pa rëndësi (të mëtutjeshme) si për gjykimin e padisë (shih



gjithashtu ASC-09-0072, ASC-09-0057, ASC-10-0027, ASC-10-0031, ASC-10-0036, etj).

Për arsyet e cekura më lartë nën a) dhe b), hedhja poshtë e padisë si e papranueshme nuk ishte e duhur. Prandaj aktvendimi i kundërshtuar nuk mund të vazhdojë dhe duhet të shfuqizohet. Trupi Gjykues do të duhej të merrej (përsëri) me padinë, duke u përmbajtur nga hedhja poshtë e mëtutjeshme duke u bazuar në arsyet e njëjta.

c. Lis alibi pendens (kundërshtimi tashmë që është në pritje diku tjetër)

Aktvendimi i Trupit Gjykues shtron pyetjen nëse padia nuk do të duhej të hidhej poshtë si e papranueshme për shkak të lis alibi pendens. Trupi Gjykues thekson në mënyrë të qartë në aktvendimin e datës 29 prill 2009 se paraardhësi i Paditësve tashmë e kishte parashtruar padinë e njëjtë pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës, dhe se Paditësit "*vazhduan*" këtë padi duke parashtruar një padi të re pranë DHPGJS-së. Është e paqartë, se si një padi në pritje – por e ndërprerë – mund të "*vazhdohet*" duke parashtruar një padi të re pranë një gjykate tjetër. Pasi që nuk ka aktvendim brenda shkresës së lëndës, që tregon ndonjë akt ligjor të transferimit të lëndës nga Gjykata Komunale e Prishtinës tek DHPGJS-ja, Trupi Gjykues i DHPGJS-së do të duhet ta sqarojë atë dhe do të duhet të merret me çështjen e lis alibi pendens.

d) Udhëzimet për parashtrimin e ankesës:

Së fundi, pika 2 e aktvendimit të ankimuar është e gabuar dhe do të duhej të eliminohej pa zëvendësim, si udhëzimet për të parashtruar një ankesë duke cituar ligjin pa ndonjë diskrecion në anën e gjykatës nuk janë aktvendime dhe andaj nuk mund të përfshihen në dispozitiv. Një informatë e tillë do të mund të jepej brenda arsyetimit ligjor ose – për më tepër – të bashkëngjitet vetëm në aktvendim, por nuk mund të jetë pjesë e tij (shih ASC-09-0108, ASC-10-0023, ASC-10-0036, ASC-09-0075 etj).

2. Aktvendimi i datës 29 prill 2010 mbi lejimin e kthimit në gjendjen e mëparshme dhe shpallja e aktvendimit të ankimuar si null the i pavlefshëm

duhet të, me rastin e ankesës dhe edhe pse nuk është ankuar drejtpërdrejt, refuzohet.

Në parim, një aktvendim i cili nuk kundërshtohet me një mjet juridik nuk mund t'i nënshtrohet aktvendimit të gjykatës së apelit. Megjithatë në rastin në fjalë, që të dy aktvendimet (ai i datës 14 janar si dhe ai i datës 29 prill 2009) janë të pandashëm, dhe Kolegji i Ankesave nuk do të ishte në gjendje të vendoste për ankesën, që është nën juridiksionin e tij ekskluziv, nëse aktvendimi i Trupit Gjykuës i datës 29 prill 2010 – i ndërmarrë ultra vires (shih më poshtë) – do të qëndronte, pasi që ka ndikim në aktvendimin i cili është objekt i ankesës në pritje. Prandaj, kompetenca e Kolegjit të Ankesave për të vendosur mbi ankesën – në këtë rast specifik – nënkupton kompetencën të refuzojë madje edhe një aktvendim për të cilin nuk është ushtruar ankesa, nëse ky aktvendim do ta pengonte Kolegjin e Ankesave në ushtrimin e kompetencave të tij lidhur me aktvendimin e ankimuar.

Aktvendimi merret ultra vires (a). Përveç kësaj, aktvendimi është i bazuar në një interpretim të gabuar të ligjit (b).

- a) Në parim, momentin kur është marrë aktvendimi i cili e përfundon procedurën gjyqësore të një shkalle, e njëjta gjykatë nuk mund ta heq më atë aktvendim. Ky parim është edhe më i zbatueshëm, kur aktvendimi i cili e përfundon procedurën gjyqësore të asaj shkalle është tashmë objekt i ankesës, siç definojnë ankesat, midis kriterëve të tjera, me efektin e tyre transferues. Kjo madje shkon për një propozim për kthimin në gjendjen e mëparshme. Neni 117 para. 2 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), që nuk është drejtpërdrejt i zbatueshëm në procedurën gjyqësore pranë DHPGJS-së (Neni 70.3 pika a UA e UNMIK-ut 2008/6), duhet të interpretohet për lëndët pranë DHPGJS-së me një zvogëlim teleologjik që nuk ka të bëjë me aktvendimet të cilat e përfundojnë procedurën gjyqësore të një shkalle.

Veç kësaj, madje edhe duke marrë parasysh një urdhër për delegim në pajtim me Nenin 11.1 të UA të UNMIK-ut 2008/6, një gjyqtar individual nuk mund ta shpall aktvendimin e panelit të plotë null dhe të pavlefshëm.

Prandaj, aktvendimi për ta shpallur aktvendimin e kaluar null dhe të pavlefshëm ishte marrë ultra vires dhe andaj është dashur që për këtë arsye të refuzohet me rastin e ankesës.

b) Aktvendimi gjithashtu është i bazuar në një interpretim të gabuar të ligjit.

Kryesisht merret me çështjen nëse njoftimi i dhënë për AKM-në nga ana e paraardhësit të Paditësve ishte i afatshëm në pajtim me Nenin 29.1 të UA të UNMIK-ut 2002/12. Kjo nuk është një çështje e cila duhet sqaruar kur shqyrtohet pyetja nëse një anashkalim për ta dorëzuar një dokument të tillë tek gjykata mund të falet sipas Nenit 117 para. 1 të LPK-së. Pyetja përkatëse për lejimin e kthimit, nëse ka pasur shkaqe të arsyeshme për mosparaqitjen e dokumentit të kërkuar (i cili, krahaso arsyetimin e mësipërm të këtij aktvendimi, është në fund pa ndonjë rëndësi), nuk përgjigjet në aktvendim, meqë Trupi Gjykses vetëm supozon se Paditësit *"nuk kanë mundur të jenë në dijeni për faktin se njoftimi ishte dërguar nga (...) {paraardhësi i tyre} në vitin 2005 dhe se ky dokument ka mundur të paraqitej tek Dhoma e Posaçme"*, që domethënë se Trupi Gjykses nuk kishte sqaruar ose së paku nuk ishte bindur për faktin se Paditësit në fakt nuk kanë ditur për këtë, por megjithatë e ka lejuar kthimin në gjendjen e mëparshme.

Gjykata duhet të bindet për faktin se janë dhënë shkaqe të arsyeshme, përndryshe, me lejimin e kthimit në gjendjen e mëparshme, do të shkel të drejtat procedurale të palës tjetër.

Së fundi, Trupi Gjykses shpalli gabimisht aktvendimin e datës 29 prill 2010 për t'u mos ankimuar, në pajtim me Nenin 122 të LPK-së.

Siç u theksua më lartë, në procedurën gjyqësore pranë DHPGJS-së, LPK-ja nuk është drejtpërdrejtë e zbatueshme. Zbatueshmëria e saj ndjek vetëm, e vetëm ndryshimet e vlerësuara si të nevojshme nga DHPGJS-ja, sipas Nenit 70.3 pika. a UA e UNMIK-ut 2008/6. Sipas Nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 dhe Nenit 58.1 të UA të UNMIK-ut 2008/6 çdo

aktvendim dhe aktgjykim i Trupit Gjykses është i zbatueshëm. Neni 12 i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 thekson qartë se dispozitat e asaj Rregulloreje zëvendësojnë çdo dispozitë tjetër të ligjit në fuqi që nuk është në përputhje me të. Përveç kësaj, gjithashtu ndjek parimet bazë të parimeve të së drejtës civile, kryesisht lex posterior derogat legi priori dhe lex specialis derogat legi generalis, se dispozitat që kanë të bëjnë me ankimin e aktvendimeve të Trupit Gjykses të dala nga Rregullorja dhe UA-ja zëvendësojnë çdo dispozitë të LPK-së.

#### Kthimi i lëndës në shkallën e parë

Që t'u jepet palëve mundësia të dëgjohen nga dy shkallët (shih ASC-09-0013), lënda duhet të kthehet për rigjykim në një përbërje tjetër të Trupit Gjykses, Neni 65 pika c UA e UNMIK-ut 2008/6.

Neni 65 pika c UA e UNMIK-ut 2008/6 parasheh diskrecionin e Kolegjit të Ankesave për të urdhëruar rigjykimin e lëndës para një Trupi Gjykses tjetër. Ky diskrecion nuk është i pakufizuar, ashtu siç është çdo diskrecion i një gjyqtari në një sistem ligjor që drejtohet nga sundimi i ligjit, jo i pakufizuar, porse i nënshtrohet kushteve të caktuara të cilat duhet të definohen mbi baza lëndore për të krijuar një praktikë gjyqësore të parashikuar. Përcaktimi i kufijve të diskrecionit, ratio legis i dispozitës duhet të merret në parasysh. Një ndër arsyet e kësaj dispozite (bashkë me mungesën e dukshme dhe të dëshmuar të paanësisë dhe asaj të specializuar për një tjetër Grup Gjykses për çështjen për të cilën duhet të vendoset) është që legjislatori ka marrë në parasysh shqetësimet e mundshme të palëve të lëndës që do të rigjykohe në lidhje me paanësinë e gjyqtarëve (shih ASC-09-0013). Pa ndonjë paragjykim për paanësinë aktuale të gjyqtarëve, që si parim mund të konsiderohet edhe në rastet kur një lëndë duhet të rigjykohet, perceptimi i palëve mund të jetë – me arsye të mira subjektive – i ndryshëm. Kur një lëndë është urdhëruar që të rigjykohet nga gjykata e shkallës së parë, perceptimi i palëve në lidhje me paanësinë e gjyqtarëve mund të jetë, që besimi i tyre në paanësinë e gjyqtarëve është i dëmtuar, pasi që gjyqtarët veçse e kanë shprehur pozicionin përfundimtar në lëndën e tyre. Natyrisht kjo nuk mund të jetë kështu çdo herë kur Kolegji i Ankesave urdhëron rigjykimin e

### XIII

një lëndë bazuar në një opinion ligjor që dallon në një pikë apo një tjetër nga ajo e Trupit Gjykses, por perceptimi i një mungese të mundshme të paanësisë bëhet akoma më i fuqishëm, në rast se Kolegji i Ankesave, në vendimin e vet ku urdhërohet rigjykimi i lëndës, dallon shumë nga opinioni ligjor i Trupit Gjykses. Prandaj, duke marrë parasysh specifikat e lëndës në fjalë, lënda duhet të dëgjohet nga një përbërje tjetër e Trupit Gjykses (për shkak të mungesës së gjyqtarëve [si ndërkombëtar ashtu edhe vendorë], DHPGJS-ja ende nuk përfshinë Trupa Gjykses të tjerë, por vetëm përbërje tjera të Trupit Gjykses).

#### Shpenzimet:

Pasi që lënda duhet të dëgjohet përsëri *ex principio* nga një përbërje tjetër e Trupit Gjykses, Kolegji i Ankesave, duke zbatuar parimin ligjor të Nenit 54 të Ligjit mbi Taksat Gjyqsore, 1987, e konsideron se është e arsyeshme që të mos ngarkojë shpenzimet e procedurës ankimore si dhe ato të procedurave gjyqsore të shkallës së parë tek të dyja palët.

Richard Winkelhofer  
Gjyqtar Kryesues i EULEX-it

nënshkruar

Torsten Frank Koschinka  
Gjyqtari i EULEX-it

nënshkruar

Eija-Liisa Helin  
Gjyqtare e EULEX-it

nënshkruar

Tobias Lapke  
Regjistruer i EULEX-it

nënshkruar